

V E N D I M
Nr.69, datë 11.2.1999

PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Punëdhënësit, që marrin në punësim të përkohshëm ose në punësim prove persona punëkërkues të papunë nga lista e zyrës së punësimit, mund të përfitojnë financim mujor të pagës dhe të shpenzimeve për sigurimet e detyrueshme të këtyre personave. Kohëzgjatja e punësimit është jo më pak se tre muaj dhe jo më shumë se gjashtë muaj. Paga kompensohet deri në masën e pagës minimale, në shkallë vendi, kurse sigurimet e detyrueshme deri në masën 100 për qind.

2. Punëdhënësit, që punësojnë, me kontratë të rregullt, për kohëzgjatje të paktën njëvjeçare, persona punëkërkues të papunë nga lista e zyrës së punësimit, mund të përfitojnë një subvencion të menjëhershëm, të barabartë me shumën e pagës minimale dhe shpenzimet për sigurimet e detyrueshme, për një periudhë deri në 5 muaj.

Në rastin kur personat e punësuar në këtë formë janë trajtuar më parë sipas pikës 1 të këtij vendimi, kompensimi bëhet për një periudhë deri në 3 muaj.

3. Në rastin kur personat e punësuar nuk kanë formimin e duhur profesional për proceset e punës, për të cilat punësohen, punëdhënësi mund të përfitojë një rritje, deri në 20 për qind të kompensimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe deri në 10 për qind të subvencionit, sipas paragrafit të parë të pikës 2 të këtij vendimi. Kur kërkohen masa të veçanta dhe shpenzime shtesë, që punëdhënësi detyrohet t'i kryejë për përgatitjen profesionale, ai ka të drejtë të kërkojë ndihmë dhe subvencion për këto shpenzime nga zyra kompetente e punësimit. Subvencioni në asnjë rast, nuk duhet ta kalojë masën 75 për qind të kostos së përgjithshme.

4. Kur personat e punësuar janë përfitues të programit të pagesës së papunësisë, punëdhënësi përfiton shtesa në masë proporcionale me numrin e muajve të pagesës së papunësisë që shkurtohen.

Për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, kompensimi mujor për pagë rritet në masën 3 për qind për çdo muaj pagesë papunësie që shkurtohet. Për rastet e parashikuara në paragrafin e parë të pikës 2 të këtij vendimi përfitohet shtesë e subvencionit në masën 25 për qind të shumës së mbetur, për t'u paguar si pagesë papunësie.

5. Në rastin kur personat e trajtuar janë pjesëtarë nga familje në ndihmë ekonomike, punëdhënësi përfiton shtesa në masë proporcionale me ndihmën ekonomike, që familja ka përfituar në vitin e fundit kalendarik.

Për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij vendimi, kompensimi mujor për pagë rritet në masën 2 për qind për çdo muaj ndihmë ekonomike të plotë dhe 1 për qind për çdo muaj ndihmë ekonomike të pjesshme. Për rastet e parashikuara në paragrafin e parë të pikës 2 të këtij vendimi, përfitohet shtesë subvencioni në masën 10 për qind të shumës së paguar për ndihmë ekonomike.

6. Fondet e pagesës së papunësisë, të kursyera nga zbatimi i këtij programi transferohen në masën 100 për qind në buxhetin e tij.

7. Ky program përfiton transferime nga buxheti i ndihmës ekonomike në masë proporcionale me kursimet e fondeve, që i sjell këtij buxheti.

Për çdo anëtar të familjes që përfiton ndihmë ekonomike, i cili punësohet sipas pikës 1 të këtij vendimi, sasia e fondeve që transferohen është në masën 30 për qind të ndihmës ekonomike të plotë për një familje me 4 persona, në një periudhë të barabartë me kohën e punësimit. Në rastin e paragrafit të parë të pikës 2 të këtij vendimi, për çdo person që punësohet, transferohet një fond i barabartë me 30 për qind të shpenzimeve, që programi i ndihmës ekonomike ka bërë për familjen e personit gjatë vitit të fundit kalendarik.

8. Zbatimi i programit bëhet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale përcakton kritere të detajuara për rastet, si dhe masën e përfitimit nga ky program dhe mbikëqyr zbatimin e tij.

9. Kostoja e këtij programi mbulohet nga fondet e buxhetit të shtetit për nxitjen e punësimit.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko